

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-028/14

**Prishtinë,
18 Nëntor 2015**

Në çështjen juridike të:

R.Xh.

Fshati Kryshevc
Komuna e Obiliqit

Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit, Rolandus Bruin dhe Anders Cedhagen, anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejme KKPK) nr. KPCC/D/R/215/2013, të datës 21 gusht 2013 (lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejshëm: AKP) me numrin KPA01363), pas shqyrtimit të mbajtur më 18 Nëntor 2015, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e R. Xh.kundër vendimit të KKPK-së nr. KPCC/D/R/215/2013, të datës 21 gusht 2013.
2. Konfirmohet vendimi i KKPK-së nr. KPCC/D/R/2015/2013 i datës 21 gusht 2013 për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me nr. KPA01363.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 4 dhjetor 2007, R. Xh. (në tekstin e mëtutjeshëm: Paraqitësi i kërkesës) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) duke kërkuar vërtetimin e të drejtës së shfrytëzimit dhe ri-posedim të banesës në sipërfaqe prej 77.14 m², që ndodhet në Rrugën e UÇK-së, Hyrja 1, kati 11, numër 46, në Prishtinë (në tekstin e mëtutjeshëm: banesa e kërkuar).
2. Paraqitësi i kërkesës ka dorëzuar në AKP, *inter alia*:
 - Vendimin për ndarje nr. 526/85 të lëshuar nga Drejtori i Ndërmarrjes Publike “COAL Elektroekonomia e Kosovës”, Departamenti për prodhimin e thëngjillit, “BOAL MS Kosova Bellaqevc”, më 22 tetor 1985 përmes të cilës Ndërmarrja Publike ia ka ndarë paraqitësit të kërkesës banesën shoqërore për shfrytëzim;
 - Kontratën për shfrytëzimin e banesës, nr. 1193/14051, e lidhur në mes të paraqitësit të kërkesës në cilësinë e Bartësit të së Drejtës së Banimit dhe Ndërmarrjes Publike Banesore (‘BVI për Banim dhe Objekte Afariste në Prishtinë’) më 5 tetor 1989. Në bazë të Vendimit për Ndarje, Ndërmarrja Publike Banesore ia dorëzon paraqitësit të kërkesës në shfrytëzim të pakufizuar banesën e kërkuar me përshkrim të atëhershëm me lokacion në Prishtinë, Rruga APJ, obj. B, nr. 46, kati 11, hyrja I, me sipërfaqe 77.14 m²;

- Një procesverbal të datës 26 qershor 1989 të lëshuar nga Njësia për Sistemin e Energjisë Elektrike-THËNGJILL në Kosovë, Njësia Punuese për Prodhimin e Thëngjillit në Kosovë, OPPB Kosovë Belacevc. Paraqitësi i kërkesës ka konfirmuar në këtë procesverbal se ai e ka marrë çelësin e banesës nga personi i autorizuar.
3. Identifikimi i banesës së kërkuar është bërë duke vendosur një njoftim në banesë. Askush nuk ka marrë pjesë në procedurë para AKP-së, kështu që Sekretaria Ekzekutive e AKP-së e ka konsideruar kërkesën si të pakontestueshme.
 4. AKP-ja ka gjetur *ex officio*, se paraqitësi i kërkesës ka paraqitur më parë një kërkesë të kategorisë “A” në Drejtorinë për Cështje Banesore dhe Pronësore (DCBP) për pronën e njëjtë (kërkesa numër DS001179) duke pretenduar se ai ishte larguar nga puna gjatë vitit 1990 dhe pastaj është dëbuar nga banesa e kërkuar. Njëkohësisht, V.L. kishte paraqitur kërkesë të kategorisë “C” në DCBP (numër DS301694) lidhur me pronën e njëjtë. DCBP-ja gjeti se paraqitësit të kërkesës të kategorisë “A” i është ndarë një banesë tjetër ku ai kishte jetuar nga viti 1990 dhe pastaj e kishte blerë atë në vitin 1998. Me vendimin e vet HPCC/D/242/2005/A&C, Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore (KKPB) e ka miratuar kërkesën e kategorisë “C” të Verica Ljiljak, bashkë me kthimin e të drejtës pronësore dhe e ka refuzuar kërkesën e kategorisë “A” pasi që paraqitësi i kërkesës nuk ka arritur të dorëzojë prova që e kishte humbur të drejtën pronësore si rezultat i diskriminimit.
 5. Kërkesa për rishqyrtim e paraqitur nga paraqitësi i kërkesës është refuzuar nga KKPB-ja me vendimin e vet HPCC/REC/71/2006, të datës 6 shtator 2006. Në paragrafin 5 të vendimit grupor, i cili sipas vendimit të vërtetuar aplikohet posaçërisht për kërkesën, KKPB-ja ka thënë se paraqitësi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë provë relevante të ligjshme, e cila nuk është marrë parasysh nga KKPB-ja kur ka vendosur për kërkesën. Prandaj, arsyetimi për refuzimin e kërkesës të kategorisë A ka mbetur siç përcaktohet në vendimin e shkallës së parë.
 6. Në raportin e përpunimit të kërkesës AKP-ja e thekson se paraqitësi i kërkesës ka konfirmuar konstatimet e DCBP-së dhe se humbja e posedimit të banesës së kërkuar nuk ishte e ndërlidhur me konfliktin (shih faqen 43 të lëndës) por që paraqitësi i kërkesës ende konsideron se e ka të drejtën pronësore ndaj banesës së kërkuar. Nuk

- ka asnjë dokument në lëndë për këtë kontakt në mes të AKP-së dhe paraqitësit të kërkesës.
7. KKPK-ja ka vendosur me vendimin e vet nr. KPCC/D/R/215/2013, të datës 21 gusht 2013, ta hedhë poshtë kërkesën. Në arsyetimin e vet (paragrafi 10 i vendimit grupor siç referohet në Vendimin e Vërtetuar) KKPK-ja ka konstaton se kërkesa është e pakontestuar.
 8. Vendimi i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës (në tekstin e mëtejme: pala ankuese) më 18 nëntor 2013.
 9. Pala ankuese ka paraqitur ankesë kundër Vendimit të KKPK-së më 4 dhjetor 2013.

Pretendimet e palës ankuese:

10. Pala ankuese thotë se vendimi i KKPK-së përmban shkelje serioze dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale si dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Ai i referohet dokumenteve që i ka dorëzuar në AKP.

Arsyetimi ligjor:

11. Pas shqyrtimit të lëndës dhe pretendimeve të palës ankuese, në pajtim me nenin 12 dhe 13 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi Zgjidhjen e Kërkesave që ndërlidhen me Pronën e Paluajtshme Private, përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerciale, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 (në tekstin e mëtuftjeshëm: Ligji i UNMIK-ut 2006/50) dhe nenin 194 të Ligjit të Procedurës Kontestimore 03/L-006, Gjykata Supreme konstaton se ankesa është e pabazuar. Arsyetimi për këtë konkluzion ndodhet në vijim.
12. Pasi që KKPK-ja e ka hedhur poshtë kërkesën por nuk ka dhënë arsyetim të detajuar për vendimin e vet, Gjykata Supreme duhet ta shqyrtojë nëse KKPK-ja ka vepruar drejtë duke e hedhur poshtë kërkesën në baza procedurale. Gjykata Supreme vendos se KKPK-ja ka vepruar drejtë megjithatë ka edhe arsye tjera për ta hedhur poshtë kërkesën.
13. Së pari, Gjykata Supreme konstaton se kërkesa e palës ankuese është shqyrtuar dhe është vendosur lidhur me të me vendimin (administrativ)

(HPCC/D/242/2005/A&C), të përmendur këtu në paragrafin 4. Ky vendim është vërtetuar dhe i plotfuqishëm me vendimin HPCC/REC/71/2006, të datës 6 shtator 2006, të përmendur në paragrafin 5, përmes së cilit është refuzuar kërkesa e palës ankuese për shqyrtim. Në pajtim me nenin 11.4 (c) të Ligjit të UNMIK-ut 2006/50, KKPK-ja duhet ta hedhë poshtë kërkesën, ku kërkesa është shqyrtuar më parë dhe lidhur me të është vendosur në vendimin përfundimtar administrativ dhe gjyqësorë. Me vendimin e KKPK-së, e drejta pronësore ndaj banesës së kërkuar i është dhënë Verica Ljiljak, ndërsa është refuzuar kërkesa e palës ankuese për ri-posedim në bazë të së drejtës për shfrytëzim e përmendur këtu në paragrafin 2. Në bazë të parimit *res judicata*, një lëndë nuk do të shqyrtohet përsëri nga gjykata, kur e njëjta çështje me palë të njëjtë pjesëmarrëse në procedurë, veçse është vendosur nga një gjykatë tjetër. Kjo është çështja në lëndën aktuale; e njëjta kërkesë është paraqitur në KKPB-së dhe KKPK-së nga paraqitësi i njëjtë i kërkesës, dhe gjithashtu, faktet, bazat ligjore si dhe çështjet e provave janë të njëjta në të dyja kërkesat të paraqitura nga pala ankuese në KKPB, gjegjësisht në KKPK.

14. Në vazhdim, në bazë të fakteve rrjedh se pala ankuese po kërkon të drejtën e shfrytëzimit të banesës me pronë shoqërore. Në pajtim me nenin 3.1 të Ligjit të UNMIK-ut 2006/50, KKPK-ja nuk ka juridiksion për kërkesat që kanë të bëjnë me të drejtat e (shfrytëzimit) të pronës së paluajtshme që nuk është pronë private. Kjo është gjithashtu bazë për ta hedhur poshtë kërkesën.
15. Së treti, nga faktet dhe deklaratat e palës ankuese rrjedh se ai e ka humbur posedimin e banesës së kërkuar kur është larguar nga puna në vitin 1990. Pasi që në pajtim me nenin 3.1 të Ligjit të UNMIK-ut 2006/50, KKPK-ja ka kompetencë për zgjidhjen e kërkesave që përfshijnë rrethanat që ndërlidhen drejtpërdrejtë apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi gjatë viteve 1998/1999, dhe pala ankuese tashmë e ka humbur posedimin vite më parë, dhe për këtë arsye KKPK-ja nuk ka juridiksion të vendos për kërkesë.
16. Fakti se KKPK-ja nuk ka dorëzuar një arsyetim bindës për vendimin e vet, nuk është arsye në vete për ta pranuar ankesën si të bazuar në këtë lëndë, pasi Gjykata Supreme mund të jap arsyetim bindës në këtë aktgjykim. Në bazë të të lartcekurave, në pajtim me nenin 13.3. (c) të Ligjit të UNMIK-ut 2006/50 dhe nenet 17 dhe 166 paragrafi 2 i LPK-së, Gjykata Supreme vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore:

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit

Rolandus Bruin, Gjyqtar i EULEX-it

Anders Cedhagen, Gjyqtar i EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it